



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



Nr. i Protokollit: 02/ 684
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Muzeqinë

E martë, më 17 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 17:45 – 19:30

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu: Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit shumë që keni ndar kohën të ju përgjigjeni ftesës tonë për këtë dëgjim publik.

Po ndihem i nderuar të jem në mesin e juaj, intelektual e njerëz të vyshëm dhe përfaqësues të familjeve të nderuara këtu në fshatin Muzeqinë.

Ju e dini tash është viti i katërt që e bëjmë buxhetin vjetor dhe para buxhetit vjetor ne e kemi një obligim ligjor të cilin e bëjmë me knaqësi sepse buxhetin dy komponentë e ndërtojnë. Komponenti i parë janë kërkesat të cilat burojnë direkt nga qytetari, dhe një nga mënyrat për t'i marrë këto kërkesa janë dëgjimet publike të cilat ne i bëjmë. Komponenti i dytë janë ato zotimet tona. Ne kur kemi ardhur para jush në krye të radhës i kemi dhënë disa zotime, një vizion se çfarë do të bëjmë, njëherë anë zotimet të cilat ne tentojmë t'i plotësojmë çdo ditë e më shumë, e në anën tjetër kërkesat, në mënyrë që zhvillimi dhe hargjimi i buxhetit të jetë sa më racional sa më i drejtë.

Komuna e Shtimes, ka një buxhet të vogël, ne e kemi gjetë diku rreth 7.8 milionë, tani është dikur rreth 11.5 milion euro, dmth nga vitet paraprake është rritur sepse inkasimi i të hyrave dhe rritjes në buxhetin e nivelit qendror ka ndikuar edhe në rritjen në nivelin lokal.

Buxheti i komunës ndahet në bazë të numrit të popullsisë dhe në bazë të teritorit dhe për 24 mijë banorë që i ka Shtimja na takojnë 11.5 milion euro. Nga këto 11.5 milion euro mbi 50% janë paga dhe mëditje, pastaj janë mallra dhe shërbime, subvencione dhe investime kapitale. Investime kapitale gjithsej janë 2.5 milion euro, këtë shumë ne duhet ta shpërndajmë në të gjithë territorin në mënyrë të barabartë.

Ne nga viti i parë jemi munduar që secilit fshat, nga 22 vendbanime gjithësej, t'i ndajmë në mënyrë proporcionale dhe të barabartë.

Ne sot jemi këtu më të vetmën arsye që investimet kapitale të cilat janë për fshatin Muzeqinë t'o orientoni ju vetë, pasi që kush më mirë se ju i din nevojat e këtij vendi.

Kësaj radhe ne kemi qenë edhe me fat pasi që e kemi pasur mbështetjen e qeverisë, shumë projekte të cilat po i shihni çdo ditë, të cilat po ndodhin, ato me buxhetin komunal nuk do të kishin mundur as me dekada t'i mbërrijm.

Vetëm tani që po flasim, me një llogaritje të cilën e kemi bërë së bashku me stafin tim, diku në proces të ndërtimit në Komunën e Shtimes vetëm për këto tre vite e gjysëm janë afër 55 milion euro buxhet nga shteti. Ne nuk jemi ndal duke trokitur derë më derë në Ministri e në qeveri, por dorën në zemër edhe qeveria ka qenë mikpritëse dhe ka qenë dashamirëse ndaj Komunës së Shtimes, për të cilën unë personalisht jam falënderues.

Tani fjalën po u'a kaloj juve që t'i paraqisni kërkesat e juaja në mënyr që ne t'i marrim dhe më pas t'i vendosim në buxhet për vitin e ardhshëm.

Kërkesat e banorëve të fshatit :

- **Burim Bibaj:** Rruga te varrezat të zgjerohet si dhe parginku të shtrohet asfalt (150m)
Mbetjet inerte dhe çështja e mbeturinave është mjaft problem i madh.
Çështja e rregullimit të kanaleve të arave si dhe rrugët e arave.
Një trafo e re të bëhet kërkesa të bëhet në rrugën "Maliq Hoxha".
- **Shaban Sejdiu:** 5 familje janë pa kanalizim në një segment në rrugën "Fehmi Agani", (400m)
- **Naim Shahini:** Gjatë periudhës së verës ujësjellësi nuk ka fare shtypje.
Është e nevojshme të bëhen disa rrugë të arave, rruga e cila lidh fshatin tonë me Tërrnin (2km), dhe një rrugë tjetër e cila lidhë Muzeqinen me Rashincës (1000m)
- **Nazim Ismajli:** Në rrugën "Fejzullahu", të vendosen pengesat në rrugë.
- **Lulzim Halimi:** Kemi nevojë për një rrugë të arave, nga ura deri te pishina Lido.
- **Tefik Zeqiri:** Ujë të pijes në fshatin Muzeqinë ne nuk kemi.
Një rrugë të arave të cilën e kemi nuk është e kalueshme kur ka të reshura të shijut, nëse është e mundshme të shtrohet prap (Gjyrkofc-Muzeqinë 200m).
Ura tek "Haxhi Halimi" të rregullohet.
- **Fadil Hoxhaj:** Ndriçimi publik në pjesën e familjes Hoxha mungojnë 10-12 shtylla.
Rruga "Isuf Hoxha", të asfaltohet(150m).

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: Muzegjine

Date: 17.06.2025

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	NAIM SHAHINI	<i>[Signature]</i>
2	Jefik Zegiri	<i>[Signature]</i>
3	Heset Zegjari	<i>[Signature]</i>
4	Jefik Zegjari	<i>[Signature]</i>
5	NAIM SHABANI	N.SH
6	Gazim Zegjari	<i>[Signature]</i>
7	JADAT HYSENI	<i>[Signature]</i>
8	NOZIM ISMOVILI	<i>[Signature]</i>
9	Shaban Zegjari	<i>[Signature]</i>
10	Naum Zegjari	<i>[Signature]</i>
11	Shaban Kadri	<i>[Signature]</i>
12	Lulzim Halimi	<i>[Signature]</i>
13	FAOIL HOXHAI	<i>[Signature]</i>
14	Hidem Krasniqi	<i>[Signature]</i>
15	Burim Bibaj	<i>[Signature]</i>
16		
17		

18		
19		
20		
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		